

Takim përshëndetës i përfaqësuesve të LOGOS-it me strukturat komunale



Kryetari i komunës së Kamenicës, z. Shaip Surdulli me bashkëpunëtorë ,e mirëpriti stafin e projektit LOGOS, në krye me menaxherin e këtij projekt z. Norbert Pijls,i me rastin e përmbylljes së aktivitetit tyre.

Surdulli,e falënderoi z. Norbert,si dhe qeverinë zvicerane financuese e projektit në fjalë , për kontributin e dhënë në komunën e Kamenicës në shumë sfera .Ai, e ilustroi me disa shembuj: aftësimi i stafit komunal me trajnimeve ,seminareve ,punëtori etj. Realizimi i projekte të infrastrukturës , rregullimi dhe mobilimi i qendrës për shërbime të qytetarëve, përgatitja e projekt rregullores dhe ndihma e organizimit të zgjedhjeve për këshillat lokale, organizimi i debateve për buxhetin komunal ,përgatitja e planit zhvillimor komunal ,si edhe atij urban. Stafi komunal dhe qytetarët e Kamenicës, janë të kënaqur me punën e mirë që e keni bërë ju për të mirën e qytetarëve të komunës së Kamenicës, tha kryetari Surdulli. Ndërsa drejtori i Administratës së Përgjithshme, z. EnverAjvazi falënderoi z. Norbert dhe stafin e tij për kontributin që e ka dhënë për drejtorinë tij, sidomos me rregullimin e qendrës për shërbimin e qytetarëve, aftësimin e stafit të kësaj qendre, kështu duke krijuar kushte të mira pune për punonjësit dhe efikasitet në shërbime për qytetarët. Ndërkaq, z. Norbert u shpreh: edhe ne kemi përfituar nga bashkëpunimi me komunën e Kamenicës ,atë që e kemi realizuar këtu me ju, e kemi aplikuar pastaj në komunat tjera .Edhe pse përfundon ky projekt, Qeveria zvicerane do të vazhdoj ti mbështes komunat e Kosovës, duke e zgjeruar numrin e tyre në 20. Ato mjete janë të taksapagueseve zviceran ,por edhe të kosovarëve që punojnë atje .LOGOS-i i kishte përgatitur ca mirënjohje për drejtori e zyrtar me të cilët kishte pasur bashkëpunim. Po ashtu në emër të komunës kryetari Surdulli i ndau mirënjohje stafit të LOGOS-it.